


Ndërtesat me tulle të kuqe dhe të bardhë në Tiranë



e verdhë - ndërtesa të parafabrikuara *e kuqe* - ndërtesa informale *blu* - ndërtesa me tulle të kuqe/të bardhë

Ndonëse është e zakonshme të identifikohet arkitektura e realizmit socialist me ndërtesat me panele të parapregatitura, në fakt ato janë pjesë e realitetit të asaj kohe, një mënyrë e gjetur për të ndërtuar me kosto më të ulët në kushtet e krizës ekonomike. Por, duke lënë mënjanë ndërtesat masive dhe monumentale si Muzeu Kombëtar, Pallati i Kongreseve, Teatri i Operës dhe Baletit etj., një tipologji tjetër ndërtimi janë edhe ndërtesat me tullë të bardhë (silikate) dhe të kuqe. Kjo tipologji e dallueshme nga materiali i përdorur, është tipike për shumicën e komplekseve të ndërtesave të banimit të pranishme në Tiranën e sotme. Këto komplekse ndërtesash njihen lehtësisht jo vetëm nga materiali karakteristik, por edhe nga organizimi i ngurtë urban, një zgjidhje e zakonshme projektimi në atë kohë, që ndiqte parimet e një modeli racional dhe thjesht funksional. Lartësia e këtyre ndërtesave përgjithësisht varion nga dy deri në gjashtë kate, me një lartësi kati prej 280cm; organizuar në ndërtesa të bashkuara ose të shkëputura, të cilat ofrojnë zgjidhje të ndryshme për planet e apartamenteve, krahasuar me ato të parafabrikuara.

Është e vështirë të identifikohet një tipologji përfaqësuese e katit tip për këtë kategori, pasi ka zgjidhje arkitektonike të ndryshme për çdo ndërtesë, si në plane apartamentesh ashtu dhe në madhësinë e tyre; megjithatë, pjesa e jashtme e ndërtesave është në një farë mënyre e jashme. Mungesa e suvatimit dhe e shtresave të tjera izoluese, duke lënë krejt të ekspozuar konstruksionin me tullë dhe llaç në fasadën e jashtme, është një nga problematikat kryesore të tipologjisë së ndërtesave me tullë. Megjithatë, prania e shkallëve të ventiluara, ose plotësisht të mbyllura me ajrosje nga tarraca, ose gjysmë të hapura, përmirëson performancën e tërë ndërtesës. Sidoqoftë, për të rritur performancën e energjisë dhe rehatinë e jetesës për banorët, kjo tipologji duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjeve të ristrukturimit sidomos në fasadë dhe tarracë apo çati.

Referenca

ESMAP, T. E. (2014). Improving Energy Efficiency in Buildings. Energy Efficient Cities. The World Bank Group.

SLED "Tipologjia e stokut të ndërtesave të banimit në Shqipëri dhe modeli i shndërrimit të tyre për shkarkime të ulta karboni në të ardhmen. Mbështetje për zhvillimet me shkarkime të ulëta karboni në Evropën JugLindore"